REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr.Br.No. KGJK, Nr.340/2017
DAT.DT. 7 dhjetor 2017
PRISHTINË - A

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 pika 1.15 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 30 paragrafi 1 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarin e Brendshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 194- të, të mbajtur me 7 dhjetor 2017, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Rregullorja Nr.09/2017 për Realizmin e Mandatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Procesit të Përgjimit të Komunikimeve Elektronike.

2. Vendimi hyn në fuqi me datë 7 dhjetor 2017.

Nehat IDIRZI,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Kryetarëve të gjykatave të Republikës së Kosovës*
- *Arkivit*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 425
DATË 07. 12. 2017
PRISHTINË

Në mbështetje nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.15 Ligji Nr. 03/L-223 Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 35 të Ligjit Nr. 05/L-030 Për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike dhe nenit 30 të Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 7 dhjetor 2017, miraton:

RREGULLORE Nr.09/2017

PËR REALIZMIN E MANDATIT TË KOMISIONERIT PËR MBIKQYRJEN E PROCESIT TË PËRGJIMIT TË KOMUNIKIMIVE ELEKTRONIKE

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

Me qëllim të realizimit të mandatit të Komisionarit, dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Zyrës së Komisionarit për Mbikëqyrjen e Procesit të Përgjimeve të Komunikimeve Elektronike (tutje: ZPKE).

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:
   1.1. Këshilli – Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
   1.2. Komisioneri - Komisioneri për Mbikëqyrjen e Procesit të Përgjimeve,
   1.3 . Zyra e Komisionerit – Stafi mbështetës për realizimin e mandatit të komisionerit,
   1.4 . SKGJK – Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Neni 3
Struktura Organizative e Zyrës së Komisionerit

1. Struktura organizative e Zyrës së Komisionerit përbëhet nga:

1.1. Komisionari;
1.2.Zyrtar ligjor;
1.3.Zyrtar i TI-së; dhe,
1.4.Staf tekniko-administrativ të Komisionerit .

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionerit përcaktohen me Ligjin për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike Nr. /L-030.

3. Komisioneri zhvillon dhe propozon rregulla administrative për përcaktimin e përgjegjësive te zyrtareve të Zyrës së Komisonerit. Këto rregulla duhet t'i dërgohen Këshillit Gjyqësor të Kosovës për miratim.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e stafit tekniko –administrative të kësaj zyreje përcaktohen me aktet të brendshme të ZPKE dhe ligjin e punës.

5. Stafi mbështes i zyrës së Komisionarit i raporton drejtpërdrejt komisionerit. Ky staf përzgjidhet nga Sekretariatit i KGJK-së.

6. Zyrtaret Administrativ të punësuar në Zyrën e Komsionerit para se të angazhohen do t'i nënshtrohen procesit te verifikimit të pastërtisë së sigurisë nga autoriteti verifikues i AKI-së, siç parashihet me ligj.

7. Numri i të punësuarave në Zyrën e Komisionerit është katër (4) zyrtar.

Neni 4
Organogrami i ZPKE

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është organogrami i ZPKE i paraqitur si shtojcë e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Shërbimet administrative

Sekretariati i KGJK-së do të jetë në shërbim të Zyrës së Komisionerit për administrimin e burimeve njerëzore, buxhetit, financave dhe logjistikës.

Neni 6

Buxheti

1. Zyra e Komisionerit ka një buxhet të veçantë brenda buxhetit vjetor të Këshillit.
2. Komisioneri ia propozon buxhetin Këshillit.

3. Komisoneri me ndihmën e SKGJK-së planifikon, shpenzon dhe i raporton Këshillit lidhur me buxhetin e Zyrës se Komisionerit

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi ditën e miratimi nga KGJK dhe nënshkrimit nga kryesuesi i KGJK-së.

Nehat IDRIZI,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Prishtinë, më datë 07.12.2017

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr.Br.No. KGJK, Nr.340/2017
DAT.DT. 7 dhjetor 2017
PRISHTINË

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 pika 1.15 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 30 paragrafi 1 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarin e Brendshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 194- të, të mbajtur me 7 dhjetor 2017, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Rregullorja Nr.09/2017 për Realizmin e Mandatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Procesit të Përgjimit të Komunikimeve Elektronike.

2. Vendimi hyn në fuqi me datë 7 dhjetor 2017.

Nehat IDIRZI,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Kryetarëve të gjykatave të Republikës së Kosovës*
- *Arkivit*